

20161894164

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË TE BANKA KREDITORE PËR RINDËRTIM („KFW“) SIPAS  
MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN "UJITJA E LUGINËS JUGORE TË  
VARDARIT-FAZA II"**

Neni 1

Në Ligjin për huamarrje të Republikës së Maqedonisë te Banka Kreditore për Rindërtim ("KFW") sipas Marrëveshjes për hua për Projektin "Ujitja e luginës jugore të Vardarit - faza II" ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 133/09 dhe 36/11), neni 5 ndryshohet si vijon:

"Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Republika e Maqedonisë, ndërsa shfrytëzues të fundit të sistemeve për ujitje të ndërtuara në kudër të projektit "Ujitja të luginës jugore të Vardarit faza - II" të financuar nga kjo hua do të jenë kooperativat bujqësore."

Neni 2

Nenet 6, 7 dhe 8 shlyhen.

Neni 3

Neni 9 ndryshon si vijon:

"Republika e Maqedonisë, huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".